



KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË

RAPORTI VJETOR i ZKKK-së 2012

Për Një Riintegrim Të Qëndrueshëm

Kthimi dhe Riintegrimi

Çështjet sociale

Banimi me qera

Ndertimi i shtëpive

Pako ushqimore

Zhvillimi i komunitetit

**Bizneset dhe gjenerimi
i të ardhurave**

Punësimi

Edukimi

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive	1
2. Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve në komunën e Gjakovës.....	5
3. Këshillat e dhëna për ekzekutivin komunal dhe autoritetet përfaqësuese.....	7
4. Projektet – në terren për komunitete dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara– aktivitetet e ndërgjegjësimit public.....	9
5. Kthimi.....	12
6. Të dhënat statistikore për të riatdhesuarit dhe përfituesit.....	13
7. Informata rreth stafit të ZKKK-së.....	16

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Duke u bazuar në rregulloren me Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2012 në bazë të detyrave dhe përgjegjësi ka kryer punë të cilat kanë promovuar dhe mbrojtur të drejtat e komuniteteve; mundësuar qasjen e barabart të tyre në shërbimet publike; bashkërenduar procesin e kthimit nga regjioni si dhe është angazhuar që kthimi dhe riatdhesimi të jenë të qëndrueshem. Rendësi të posaqëm gjatë këtij viti iu është kushtuar punës me personat e riatdhesuar nga vendet e Evropës.

Gjatë këtij viti ZKKK kishte pranuar një varg kërkesash nga komunitetet për strehim e që ishte si një ndër kërkesat më të mëdha, ndihma ushqimore, si dhe për lëndë djegëse. Shihet qartë se ka shtim të varfërisë, kjo si rezultat i papunësisë së madhe në mes të komuniteteve e që gjatë kohës së dimrit keqësohet edhe më shumë.

Sa i përket Kthimit të të zhvendosurve brenda vendit si dhe personave të zhvendosur në vendet e rajonit siç është Mali i Zi për vitin 2012 ishte kthyer një familje 5 anëtarëshe e komunitetit Egjiptian të cilit ju kishte ndërtuar edhe shtëpia. Ndërsa, ishin paraparë që të ndërtohen edhe 13 shtëpi për familjet e zhvendosura, por Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk arriti ti financojë ndërtimin e tyre duke u arsyetuar se nuk kishte buxhet. Edhe pas 14 vjet pas zhvendosjes sipas të dhënave të UNHCR-së ende ekziston një numër shumë i madh i familjeve që janë zhvendosur në Mal të Zi e që mendohet të jetë rreth 800, kurse rreth 43 familje apo 213 persona të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që janë të zhvendosur në Mal Zi kanë shprehur dëshirën për tu kthyer, por shumica e tyre nuk kanë pronë, prandryshe kthimi i tyre në Komunën e Gjakovës nuk paraqet ndonjë problem sa i përket sigurisë apo pranimi të komunitetit shumicë.

Riatdhesimi nga vendet e Evropës si një proces që kishte filluar të merr vëmendjen e Qeverisë së Kosovës që prej vitit 2010, përkatësisht nga fillimi i vitit 2011 ku ishte alokuar edhe buxheti për riintegrimin e personave të riatdhesuar, ende mbetet proces i vështirë. Me sa duket zbatimin e vendimeve të marra nga niveli qendror vazhdon të mbetet shqetësim për arsye të zgjatjes në vënjen në jetë të vendimeve të marra në nivelin qendror që nganjëherë të jep përshtypje që kjo ngecje e pamundëson riintegrimin e qëndrueshëm. Një gjë që është për tu vlerësuar është nxjerrja e rregullores nr.10/2012 për menaxhimin e programit, organet

kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, në bazë të cilës themelohen edhe Komisioni Komunal për Riintegrim I cili mirret me shqyrtimin e kërkesave siq janë: banimi me qera, pakos emergjente, trajtimit mjekësor, edukimit, e që më parë ishin shqyrtuar në nivelin qendror. Përveç banimit me qera, Qeveria e Kosovës dhe Komunitet Komunal ende nuk kanë gjetur zgjidhje për strehim të përhershëm për personat e riatdhesuar që nuk kanë tokë as shtëpi në pronësi individuale. Ndërsa numri i të riatdhesuarve për vitin 2012 krahasuar me 2011 tregon rënjë. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Komunën e Gjakovës janë riatdhesuar 166 persona, prej tyre 130 Shqiptarë, 14 Romë, 11 Ashkali, 7 egjiptian si dhe 4 Serb.

Ndërsa, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2012 ka pranuar një numër të madh kërkesash nga personat e riatdhesuar për strehim, pako emergjente (artikuj ushqimore, higjenik si dhe dru zjarri), një numër të konsiderueshëm të planeve të biznesit, si dhe një numër të vogël të kërkesave për ndërtim dhe rindërtim. Gjatë vitit 2012 ZKKK ka pranuar gjithsej 206 kërkesa ku dhe i ka procesuar për shqyrtim në Bordin Ekzekutiv për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe në Komisionin Komunal për Riintegrim, të dy këto organe kompetente për shqyrtimin e kërkesave. Sipas ndarjes etnike nga këto kërkesa kemi pranuar 114 kërkesa nga komuniteti Shqiptar, 54 nga komuniteti Egjiptian, 28 nga Komuniteti Romë, 8 nga komuniteti Ashkali si dhe 2 nga komuniteti Boshnjak. Të aprovuar nga këto kërkesa janë 176 duke përfshirë këtu edhe përsëritjen e kërkesave 6+6+3 muaj, ndërsa 30 kërkesa janë të refuzuara për shkak të mospërbushjes së kriterëve. Nga kërkesat e aporovuara përveq ushqimit dhe artikujve higjenike kemi edhe 32 raste të aprovuara të banimit me qera ,nga 52 kërkesa të planeve të biznesit të aprovuara kemi 21 kërkesa, 10 kanë mbetur për tu shqyrtuar kurse pjesa tjetër është refuzuar. Sa I përket ndërtimit, nga fondi për riintegrim është ndërtuar vetëm një shtëpi. Ndërsa sa I përket punësimit nga programi për riintegrim kemi arritur që ti punësojmë përkohësisht me nga 3 muaj 15 persona të riatdhesuar në projektin që zbatohet nga UNDP-ja në bashkëpunim me zyrat regjionale të punësimit dhe ZKKK Gjakovë. Në projektin e punësimit nga ky numër 6 janë Egjiptian, 5 Shqiptar si dhe 4 të komunitetit Romë.

Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve në komunën e Gjakovës

Sipas Profileve të komuniteteve të publikuara nga OSBE-ja në Komunën e Gjakovës jeton një numër i konsiderueshëm i komunitetit Egjiptian si komuniteti më i madhi sa i përket pakicave, pastaj komunitetet tjerë siç janë ai Ashkali dhe Romë si dhe një numër shumë i vogël i komunitetit Boshnjak. Numrin total i komuniteteve pakicë që banojnë në Komunën e Gjakovës është rreth 8.685¹:

Nr.	Komuniteti	Numri I banorve
1.	Egjiptian	7.735
2.	Ashkali	270
3.	Rom	650
4.	Boshnjak	30
Totali		8.685

Ndërsa sipas rezultateve përfundimtare të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë që është mbajtur në vitin 2011², ky numër ndryshon dukshëm në 6.679 persona për arsye se disa nga pjestarët e komunitetit egjiptian nuk e kanë deklaruar përkatësin etnike, apo janë deklaruar si komunitet shumicë për arsye të ndryshme. Nga ky aspekt në komunën e Gjakovës del se banojnë këto komunitete pakicë siq janë: Egjiptianët me numrin më të madh të banorve 5.117; Romët me 738 banorë; Ashkalitë me 613 banorë; Boshnjakët me 73 banorë; Serbët me 17 banorë; Turqit me 16 banorë; Goranët me 13 banorë si dhe si të tjerë janë identifikuar rreth 92 banorë.

¹ Profilet e komuniteteve të Kosovës,, "Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë", 2010.

² Agjensia e statistikave të Kosovës, "Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare si dhe banesave në Kosovë", rezultatet përfundimtare, Të dhënat Kryesore, 2011;
http://esk.rksgov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

Shiko Tabelen e banorëve të komuniteteve pakicë të dala nga regjistrimi I fundit i popullsisë

në Komunën e Gjakovës.

Nr.	Komuniteti	Numri I banorve
1.	Egjiptian	5.117
2.	Ashkali	613
3.	Rom	738
4.	Boshnjak	73
5.	Serbë	17
6.	Turqi	16
7.	Goran	13
8.	Të tjerë	92
Totali		6.679

Këshillat e dhëna për ekzekutivin komunal dhe autoritetet përfaqësuese

Duke krahasuar këshillat e dhëna në raportin e vitit 2011, janë marrë parasyesh dhe janë zbatuar disa nga to siç janë:

- Janë marrë vendimet për pozitat e reja të ZKKK-së të paraparë me rregulloren 2/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim ashtu siç kemi rekomanduar ndrrimin e pozitave prej të vjetrave në të reja;
- Kuvendi ka miratuar Planin Komunal të Veprimit I cili ishte reviduar nga organizata ATA me financim të SOROS-it për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian;
- Komuna ka ndarë një buxhet të vogël që ka për qëllim zbatimin e planit të veprimit.

Ndërsa mbetet që për vitin 2013 të mirren parasysh këto këshilla apo rekomandime nga Komuna, Ministria e Punëve të Brendëshme si dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim

- Komuna e Gjakovës duhet ta ketë prioritet zbatimin e planit komunal të veprimit I cili u miratua gjatë vitit 2012;
- Projektet rreth investimeve kapitale ekskluzivisht duhet ti ketë ZKKK ashtu siç I kanë Komunitet tjerë përndryshe realizimi i tyre do të jetë i vështirë për shkak të mos planifikimit të buxhetit për projektet e komuniteteve nga Drejtoritë tjerë;
- Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet që për vitin 2013 ti ndërtojë të gjitha shtëpijat të cilat I kishte aprovuar gjatë viteve 2011-2012
- Komuna dhe Ministria e Punëve të Brendëshme, gjegjësisht departamenti për riintegrim duhet ta trajtojë çështjen e banimit të përhershëm për personat e riatdhesuar që nuk kanë shtëpi në pronësi individuale në mënyrë që të bëhet zgjidhje përmanente për personat që nuk kanë pronë;
- Të gjitha vendimet e marra nga Komisioni Komunal për Riintegrim si dhe nga Bordi për riintegrimin e personave të riatdhesuar duhet të zbatohen menjëherë nga ana e MPB-së, e jo të zhagiten me muaj të tërë;

Projektet – në terren për komunitete dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara– aktivitetet e ndërgjegjësimit publik

Zyra Komunale për komunitete dhe kthim gjatë vitit 2012 kishte organizuar një varg aktivitetesh, ku vlen të cekën disa nga më të rendësishme siç janë:

- Fushata për regjistrimin e fëmijëve të komuniteteve si dhe ata të riatdhesuar në shkollë me titullin “Prindër me kohë!”, e cila u mbajt në Prill të vitit 2012;
- Organizimi I një takimi me të rinjtë e komuniteteve të riatdhesuar të organizuar nga ZKKK në bashkëpunim me NDI

❖ Ndërtimi i shtëpive

Gjatë vitit 2012 përveç kërkesave të mëdha për strehim nga komunitetet, kishte edhe shumë djetegje të shtëpijave për shkaqe të rrymës nga lidhja e shkurtë. Në fillim të vitit 2012 ishte djegur shtëpia e Qel Bajramit në fshatin Skivjan, atëhere e Ismet Berishes në rr. Musa Zajmi në Gjakovë, shtëpitë e Cen dhe Nevruz Banushi në dardani, shtëpia e Fillim Gugës në Brekoc si dhe Burim Zeka në fshatin Skivjan. Në pamundësi buxhetore për të ju ndërtuar shtëpitë e tyre ZKKK ka ndihmuar të gjitha këtyre familjeve me subvencione në vlerë prej 4.000 euro. Ndërsa ishin ndërtuar vetëm dy shtëpi të djegurat:

- Ismet Berisha I riatdhesuar nga Gjermania, shtëpia u ndërtua me financimin e fondit për riintegrim nga Ministria e Punëve të Brendëshme, si dhe
- Zenel Kosari nga komuniteti Rom, shtëpia u ndërtua nga fondi i zyrës për Çështje të komuniteteve pran zyrës së Kryeministrit me participim të Komunës së Gjakovës me 20 % të mjeteve apo rreth 5.000 euro, shtëpia e të cilit ishte djegur në vitin 2010;

Poashtu nga projekti për ndërtimin e shtëpive në lagjen Ali Ibra I cili implementohet nga Karitasi Zvicëran e që kishte filluar ndërtimi I tyre në vitin 2010, për fazën e parë ishin përfunduar 29 shtëpi ku dhe janë strehuar po aq familje të komuniteteve në këtë lagje. Ndërsa gjatë vitit 2012 ka filluar edhe faza e dytë e ndërtimit të shtëpive, ku pritet që të ndërtohen rreth 35 shtëpi gjatë vitit 2013.

Projekti HIP Ali Ibra /Gjakove 2011/12 Faza e II. e ndertimit

Nr	Lista Prioritare e perfituesve	Participim i deklaruar pune vullnetare	Dite pune	Anetar	Kat.A	Kat.B	Kat.C	Kat.D	Nenshkrimi i perfituesit
1	Shpetim Shkodra	Kontributi I konfirmuar	30	5		1			
2	Shyhrete Krusha	Kontributi I konfirmuar	30	1	1				
3	Shefqet Govedari	Kontributi I konfirmuar	30	7			1		
4	Hamit Gashi	Kontributi I konfirmuar	30	8			1		
5	Muhamet Bajrami	Kontributi I konfirmuar	30	7			1		
6	Agim Gashi	Kontributi I konfirmuar	30	8			1		
7	Shpetim Bajrami	Kontributi I konfirmuar	30	8			1		
8	Dahim Bajrami	Kontributi I konfirmuar	30	5		1			
9	Avdi Quni	Kontributi I konfirmuar	30	5		1			
10	Gzim Cufa	Kontributi I konfirmuar	30	6		1			
11	Ibrahim Gashi	Kontributi I konfirmuar	30	7			1		
12	Refki Ibrahimimi	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
13	Agim Ibrahimimi	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
14	Mehmet Nuka	Kontributi I konfirmuar	30	8			1		
15	Danush Krusha	Kontributi I konfirmuar	30	7			1		
16	Arben Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	6		1			
17	Nazmije Bardosana	Perfituesi ka vdekur dhe duhet zavendesuar me nje perfitues tjeter							
18	Muharrem Hasi	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
19	Florent Berisha	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
20	Haxhi Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	1	1				
21	Alfred Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
22	Hanemshahe Gorani	Kontributi I konfirmuar	30	3	1				
23	Muharrem Golluba	Kontributi I konfirmuar	30	1	1				
24	Verdi Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	4		1			
25	Hatixhe Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	3	1				
26	Ganimete Kadrija	Kontributi I konfirmuar	30	3	1				
27	Ram Gashi	Kontributi I konfirmuar	30	6		1			
28	Jakup Hajra	Kontributi I konfirmuar	30	5		1			
29	Shpetim Smaqi	Kontributi I konfirmuar	30	8			1		
30	Raza Gashi	Kontributi I konfirmuar	30	2	1				

31	Minir Sofra	Kontributi I konfirmuar	30	4		1		
32	Hysen Kryeziu	Kontributi I konfirmuar	30	7			1	
33	Esheref Kabashi	Kontributi I konfirmuar	30	7			1	
34	Xhafer Shkodra	Kontributi I konfirmuar	30	8			1	
35	Hatmane Krasniqi	Kontributi I konfirmuar	30	6		1		
			1020	176	7	15	12	0

Data :25.05.2012 / Vendi : Koloni / Gjakove

❖ Projektet për biznes, gjenerim të të ardhurave dhe punësim

Në kuadër të projektit për stabilizim të komuniteteve, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) vazhdon projektin e tij duke i ndihmuar bizneset e komuniteteve në Komunën e Gjakovës. Duke marrë parasysh se projekti vazhdoj të implementohet vonë në 2012 arritën që të aplikojnë shumë biznese, ndërsa ishin aprovuar rreth 6 biznese ndër të cilat janë edhe dy shkolla një në Bec e një në Skivjan ku do të ndërtohen sallat e sporteve.

❖ Subvencionimi

ZKKK gjatë vitit 2012 nga pozicioni I subvencioneve ka ndihmuar disa raste të veshtira sociale, siç janë mbulimi i shpenzimeve të varrimit, mbështetje në riparimet e shtëpive të djegura gjatë vitit 2012, hapja e një pusi në fshatin shqiponjë, mbështetja për festimin e ditës ndërkombëtare të romëve, si dhe ndihmohet një familje për instalimin e rrymës elektrike, një person me sëmundje të kancerit si dhe kemimbështetur rregullimin e rrethojave dhe dyerve të varrezave të serbëve në fshatin Osek të Gjakovës, shih si në vijim:

- tetë kërkesapër mbulimin e shpenzimeve të varrimit për familjet që kishin gjendje të rëndë socio ekonomike në vlerë prej 1.525 euro;
- rreth 5000 euro ZKKK ka bashkëfinancuar ndërtimin e shtëpisë së djegur të Zenel Kusari;
- Si dhe rreth 3.200 euro janë dhënë për riparimin e shtëpive në Bec të 2 familjeve Berisha;
- mbështetur ditën ndërkombëtare të romëve në komunën e Gjakovës duke përkrahur organizatën Amare ternipe me 500 euro;

- Ndërsa, nga kërkesat tjera të komuniteteve kemi përkrahur kërkesat nga fshati Shqiponjë për hapjen e dy puseve për familjet e komuniteteve, ku brenda mundësive buxhetore kemi dhënë 500 euro për hapjen e një pusi,
- ndërsa me 594 euro është ndihmuar një familje e komunitetit egjiptian për instalim të rrymës elektrike,
- 200 euro kemi ndihmuar një person të sëmuar me kancer.
- Ndërsa, me kërkesë të policisë së Kosovës kemi rregulluar dyert dhe rrethojat e varrezave të serbëve në fshatin Osek në vlerë prej 600 euro.

Poashtu përveç bashkëpunimit me shumë organizata lokale dhe ndërkombëtare vlen të cekët se organizata e UNHCR-së me seli në Pejë jo vetëm se është e involvuar në bashkërendimin e kthimit të të zhvendosurve por në vazhdimësi e sipër kishte mbështet edhe kërkesat e komuniteteve pakicë, përkatësisht raste të rënda sociale. Gjatë vitit 2012 UNHCR kishte mbështetur trajtimin mjekësor të katër personave siç është intervenimin kirurgjik të një foshnjës si dhe trajtimin mjekësor të tri femrave si dhe ka mbështetur dy persona në fushën e edukimit të lartë, e gjithë kjo në vlerë prej 2.325 euro.

Kthimi

Kthimi i personave të zhvendosur brenda vendit dhe i atyre të zhvendosur në vendët e rajonit siç janë Serbia dhe Mali i Zi është një ndër aktivitetet e rëndësishme të ZKKK-së. Gjatë vitit 2012 ishte kthyer vetëm një familje 5 anëtarëshe e komunitetit Egjiptian ku dhe iu kishte ndërtuar edhe shtëpia me fondet e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, ndërsa vitin e kaluar Ministria për Kthim dhe Komunitete kishte aprovuar edhe 13 shtëpi e që në mungesë të fondeve nuk kishte arritur që ti ndërtonte. Sipas të gjitha gjasave MKK do ta konsideroj ndërtimin e këtyre shtëpive këtë vit. Sipas të dhënave të posedon UNHCR-ja në Mal të Zi janë të zhvendosur rreth 800 persona të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që gjenden në Mal të Zi, kjo e dhënë duhet të riverifikohet. Ndërsa personat që kan shpreh dëshirën për tu kthyer në vendin e tyre të origjinës janë rreth 43 familje apo 231 persona e që shumica e tyre nuk kanë tokë në pronësi individuale.

Të dhënat statistikore për të riatdhesuarit dhe përfituesit

Gjatë vitit 2012 janë riatdhesuar dhe ripranuar gjithësej 166 persona në Komunën e Gjakovës, prej tyre 130 Shqiptarë, 14 Romë dhe 11 Ashkali dhe Egjiptian, dhe 4 Serb. Ndërsa, nëse krahasojmë me vitin 2011 del se në vitin 2012 kemi patur më pak të kthyer sesa në vitin 2011. Shiko tabelat si më poshtë:

TË DHËNAT PËR VITIN 2011

Komuna	Personat e ardhur në komunën tuaj											
Gjakovë	Vendi-komuna nga kanë ardhur	Numri i ekonomiv e familjare	Numri i personave	Etniciteti								Gjithsej
				Shqiptarë	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Tjere	
	Amerika	6	7	7								7
	Anglia	2	2	2								2
	Austria	22	25	24						1		25
	Gjermania	53	55	36				8	10	1		55
	Hungaria	21	21	18				3				21
	Italia	4	7	3				4				7
	Franca	6	8	8								8
	Suedia	8	13	12						1		13
	Meksika	1	1	1								1
	Zvicra	35	48	38				1	9			48
	Belgjika	19	24	16				8				24
	Norvegjia	2	2	2								2
	Holanda	2	2	2								2
	Luksemburgu	2	2	2								2
	Kanada	2	2	2								2
Sllovenia	1	1	1								1	
Danimarka	2	2	2								2	
Gjithsej		191	222	176				24	19	2		222

TË DHËNAT PËR VITIN 2012

Komuna	Personat e ardhur në komunën tuaj											
Gjakovë	Vendi- komuna nga kanë ardhur	Numri i ekonomiv e familjare	Numri i personav e	Etniciteti								Gjithsej
				Shqiptarë	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Tjere	
	Amerika	6	6	6								6
	Austria	13	15	15								15
	Belgjika	6	12	5				1		6		12
	Franca	4	8	8								8
	Gjermania	28	39	18				11	9	2		40
	Hungaria	28	32	30				2				32
	Kanada	3	8	8								8
	Luksemburg u	1	3		3							3
	Norvegjia	3	5	5								5
	Suedia	7	12	11					1			12
	Zvicra	24	26	24	1				1			26
Gjithsej		123	166	130	4	0	0	14	11	7	0	167

Ndërsa ZKKK gjatë vitit 2012 ka pranuar 206 kërkesa të personave të kthyer gjatë viteve 2008-2009 e posaqërisht të viteve 2010, 2011 dhe 2012. Ndërsa prej 206 kërkesave janë aprovuar 160 kërkesa, 15 janë në shqyrtim e sipër kurse 30 kërkesa janë refuzuar. Vlen të cekët se Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR) I cili ishte themeluar me vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës më dt.19.07.2012. KKR deri më tani ka mbajtur tre takime ku ka shqyrtuar rreth 81 kërkesa të ndryshme për banim me qera, pako emergjente (ushqimore, higjienike dhe dru zjarri), si dhe tratim mjeksorë dhe barna. Prej tyre ka aprovuar 66 ku ka refuzuar 15 kërkesa për arsye të mospërbushjës së kriterëve të dalura nga Rreg 10/2012.

Shiko formen tabelare të kërkesave të dërguara për shqyrtim në Bord dhe KKR në bazë të përkatësis etnike:

Kërkesat e dërguara që nga Janar – Dhjetor 2012		
Nr.	Përkatësia Etnike	Nr.i kërkesave të dërguara
1.	Shqiptar	114
2.	Egjiptian	54
3.	Romë	28
4.	Ashkali	8
3.	Boshnjak	2
Gjithsej		206

Kërkesa të aprovuara, të refuzuara, dhe në shqyrtim

	Të aprovuara	Të refuzuara	Në rishqyrim
Pako ushqimore dhe higjenike	160	30	0
Dru zjarri	121	15	0
Banim me qera	36	10	0
Plane të biznesit	24	10	5
Ndërtim dhe rindërtim	2	5	0
Punësimi	15	5	5

Informata rreth stafit të ZKKK-së

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim bazuar në Rregullorën Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim ka përbërje të stafit prej pesë personave:

1. Armend Behluli - Shefi I Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
2. Bashkim Kurti – Kordinator për të Drejta dhe Integrim
3. Faton Gutaj – Kordinator për Kthim të Qëndrueshëm
4. Florije Zhubi – Zyrtare për të Drejta dhe Integrim
5. Kapllan Kërshi – Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm